

KËRKESË
Nr.5726/3, datë 29.12.2011

SHPALLJE KËRKESE PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Ministria e Punëve Publike dhe Transportit shpall kërkesën për shpronësim për interes publik të pasurive të paluajtshme pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor Tiranë-Elbasan (toka dhe objekte).

Subjekti kërkues i këtij objekti është Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve. Me anë të këtij publikimi në shtyp kërkojmë të vëmë në dijeni personat të cilët preken nga ky shpronësim.

Vënia në dijeni konsiston në masën e vlerësimit të llogaritur në bazë të vendimit nr.138, datë 23.3.2000 të Këshillit të Ministrave “Për kriteret teknike të vlerësimit dhe të përlllogaritjes së masës së shpërblimit të pasurive që shpronësohen, të pasurive që zhvlerësohen dhe të të drejtave të personave të tretë, për interes publik”, të ndryshuar (sipërfaqet m²), si dhe në bazë të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.138, datë 23.3.2000 (objektet), për pronarët sipas listës emërore bashkëlidhur.

Pronarët që kanë emrin në listën emërore dhe personat e tretë, brenda 15 ditëve nga plotësimi i këtij afati për publikim, kanë të drejtë të paraqesin pretendimet e tyre lidhur me çmimin, sipërfaqen, titullin e pronësisë, apo llojin e pasurisë që kanë në pronësi, të shoqëruar me dokumentet përkatëse në ministrinë kompetente (Ministria e Punëve Publike dhe Transportit).

Pasuritë për të cilat është bërë shënimi në kolonën përkatëse “Rikonfirmim”, sqarojmë se nga konfirmimet e dhëna nga zyrat vendore të regjistrimit të pasurive të paluajtshme, ka paqartësi apo mangësi të dhënash. Për këto pasuri do të rimerret konfirmim pranë ZVRPP-ve, Tiranë dhe Elbasan, dhe në bazë të konfirmimeve që do të jepen nga këto zyra, do të hartohen dhe listat përfundimtare të cilat do të propozohen për miratim pranë Këshillit të Ministrave.

Për pasuritë për të cilat në kolonën përkatëse është bërë shënimi “I pakonfirmuar”, sqarojmë se mungojnë konfirmimet nga zyrat vendore të regjistrimit të pasurive të paluajtshme, Tiranë dhe Elbasan (për tokat), si dhe nga ALUIZNI (për objektet). Personat të cilët pretendojnë pronësinë mbi këto pasuri duhet të aplikojnë për regjistrimin e tyre pranë ZVRPP-ve Tiranë dhe Elbasan, në të kundërt nuk do të kompensohen për efekt shpronësimi. Lidhur me objektet, sqarojmë se jemi në pritje të konfirmimit nga ALUIZNI. Në bazë të konfirmimit që do të jepet nga ky institucion, do të hartohen dhe listat përfundimtare, të cilat do të propozohen për miratimin pranë Këshillit të Ministrave.

Për objektet për të cilat është bërë shënimi “Rikonfirmim”, sqarojmë se do të rimerret konfirmim pranë ZVRPP-ve Tiranë dhe Elbasan lidhur me titujt e pronësisë dhe të dhënave të tjera, të cilat figurojnë të regjistruara. Në bazë të konfirmimeve përfundimtare që do të jepen nga këto zyra, do të hartohet dhe lista e cila do të propozohet për miratim pranë Këshillit të Ministrave.

Për pasuritë për të cilat pronar është shteti apo i paidentifikuar dhe në kolonën përkatëse është vendosur përdoruesi, sqarojmë se personat të cilët kanë në përdorim këto pasuri duhet të aplikojnë për regjistrim pranë zyrës vendore të regjistrimit të pasurive të paluajtshme, në të kundërt nuk do të kompensohen për efekt shpronësimi.

Vlera totale e këtij shpronësimi është 660 540 538.75 (gjashtëqind e gjashtëdhjetë milionë e pesëqind e dyzet mijë e pesëqind e tridhjetë e tetë pikë shtatëdhjetë e pesë) lekë.

MINISTRI I PUNËVE PUBLIKE
DHE TRANSPORTIT
Sokol Olldashi